

*Kryetarit*  
*Df. 20.04.18*

*[Signature]*

*2039*

*Df. 20.04.18*

"C & S ENERGY" Sh.p.k. K92402005Q  
Selia: Rr. e Kavajes, Nr. 151 Tirane, Shqiperi  
Adresa elektronike: csenergy2013@yahoo.com

Nr\_514\_Prot\_

Date\_18\_04\_2018

Drejtuar: BASHKISE LIBRAZHD  
Kryetarit Z. Kastriot Gurra  
Adrese : Sheshi Gjorg Golemi", Librazhd

Lenda: Kthim Përgjigje Shkresës Tuaj 2018\_03\_29\_Nr\_1625\_Prot\_kerkese per demshperblim

**I Nderuar Zotëri,**

Në vijim te Shkresës Tuaj "Kërkesë për Dëmshpërblim" Nr: 1625 Prot. Date 29.03.2018 ju bëjmë me dije se kemi pare me kujdes problematikat e ngritura ne kërkesën tuaj për dëmshpërblim dhe vërejmë disa paqartësi, si edhe fakte e rrethana qe nuk qëndrojnë ashtu siç janë përshkruar, te cilat nuk mund te çojnë ne fajësimin tone lidhur me situatën e ndodhur ne Urën e Varur, ne fshatin Togëz.


Se pari, duam te nënvizojme faktin se ne nuk kemi ne dispozicion Aktin e Ekspertimit te përgatitur nga ekspertet e Bashkisë Librazhd. Kjo do te ishte një mënyrë shume e mire qe te mund te verifikojme pretendimet e tyre, si dhe te mund te shohim e te konstatojmë se sa këto pretendime qëndrojnë ne realitet dhe se si këto lidhen me aktivitetin tone.

Se dyti, sa i përket ankesave nga banoret e fshatit apo te Kryesisë se tij, ju bëjmë me dije se kemi përmbushur plotësisht detyrimet e tona si dhe kërkesat e banorëve të pasqyruara në Marrëveshjen e datës 19.02.2014 dhe qe prej asaj kohe kemi pasur marrëdhënie shume te mira dhe korrekte me këtë komunitet, për te cilin nuk kemi dëgjuar e as marre ndonjë ankese apo kërkesë tjetër lidhur me shqetësimet e parashtruara ne Marrëveshjen e datës 19.02.2014, edhe pse kane kaluar rreth 3 vite nga përfundimi i veprës.

Sa i përket dëmtimeve qe mund ti kenë ardhur çfarëdo vepre publike ne Bashkinë e Librazhdit prej shirave te shpeshta dhe dëmtimet e pësuarra prej tyre, ato nuk mund ti ngarkohen askujt pasi ato klasifikohen ne grupin e forcave madhore.

Se treti, sa i përket dëmeve te pretenduara ne shkresën tuaj për te cilat bëni reference ne kontratën koncesionare, VNM paraprake apo kontratën e qerase për fondin kullesor dhe pyjore me Komunën Qendër ju bëjmë me dije se : investimi i koncesionarit C&S Energy ne rruge apo vepra te tjera ndërlidhëse varet nga interesi i koncesionarit ose me riparimin e dëmeve qe ky i fundit mund te ketë shkaktuar gjate ndërtimit.





“C & S ENERGY” Sh.p.k. K92402005Q  
Selia: Rr. e Kavajes, Nr. 151 Tirane, Shqiperi  
Adresa elektronike: csenergy2013@yahoo.com

Hydrocentrali Rrapun 3&4 ka rreth tre vjet qe është ndërtuar dhe se për ndërtimin e tij koncesionarit C&S Energy ka pasur një leje te miratuar nga Këshilli Kombëtarë i Territorit, dhe gjate ndërtimit e deri me sot nuk është konstatuar asnjë dëmtim ne rrugët apo urat e kalimit.

Se katërti, sa i përket urës se rene dakord ne marrëveshjen e datës 19.02.2014 te lidhur mes Komunës Qendër dhe koncesionarit C&S Energy , investimi ne ndërhyrje dhe rikonstruksion tashme është kryer plotësisht prej nesh dhe se ajo marrëveshje apo parashikimet e radhitura nuk lidhen ne asnjë mënyrë me këtë pretendim te ri te paraqitur prej jush.

Sa me sipër, me gjithë dëshirën e mire , ne dritën e fakteve dhe argumenteve te mësipërme e konsiderojmë kërkesën tuaj për dëmshpërblim te pambështetur dhe te papranueshme.

Duke shpresuar ne mirëkuptimin Tuaj!

Me respekt shoqeria, “C & S ENERGY” Sh.p.k.  
Administrator  
Harallambe GJOKA

